

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kryetari i PDK-së: Nga sot fillon një fazë tjetër
ADRESA	https://www.albinfo.ch/kryetari-i-pdk-se-nga-sot-fillon-nje-faze-tjeter/
BURIMI	albinfo.ch
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 16:28:21 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	5 shtator 2026, 14:30:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	22517a0495f080004b7b2b3ce1b198c594aa8f5a2e4df5100e4925eb7f164ab9
TEKSTI	039b823cae8b855c86d53d71fe74f81810ffe7e16f0af2b73c1b5f23066aa704
PAMJA	c91a861aa3598fc1016a4d82693764bade3c560f9f153f50e8dcb825826d75f8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	45336e290b386edc384ac3655ccf9389d69a8c39e907ea180f1d2e2c0f2192d4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	af509d61787472ec8e41e2e6baaa0db3fd07d4af4f7a54c9293cb47ba3acab88
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/45336e290b386edc384ac3655ccf9389d69a8c39e907ea180f1d2e2c0f2192d4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



Na ndiqni:

- [Facebook](#)
- [Twitter](#)
- [Instagram](#)
- [LinkedIn](#)

- [Shqip](#)
- [Deutsch](#)
- [Français](#)

Search...

E diel 6 Shtator 2026 [Shkarko App..](#)

- [Shqip](#)



[menu](#)

WHO'S WHO?

[Bekim Zogaj](#)

[Të gjitha](#)

- [E-Diaspora](#)
- [Jeta në Zvicër](#)
- [CH-Ballkani](#)
- [Albinfo.tv](#)
- [Kultura](#)
- [Sport](#)
- [Financa](#)
- [Bizneset](#)
- [Shoqatat](#)
- [Kalendari](#)
- [Të tjera](#)

Search...

X

- [Jeta në Zvicër](#)
- [Jeta në Gjermani](#)
- [Jeta në Austri](#)
- [E-Diaspora](#)
- [CH-Ballkani](#)
- [AT Ballkani](#)
- [Albinfo.tv](#)
- [Kalendari](#)
- [Sport](#)
- [Bizneset](#)
- [Financa](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shoqata](#)
- [Opinione](#)
- [Arkitektët shqiptarë në Zvicër](#)
- [Arkitektët shqiptarë në Austri](#)
- [Arkitektët shqiptarë në Gjermani](#)
- [Shqiptarët që ndajnë drejtësinë në Zvicër](#)
- [Bankierët shqiptarë në Zvicër](#)
- [Gastronomët shqiptarë në Zvicër](#)
- [Receta shqiptare gatimi](#)
- [Gastronomët shqiptarë në Austri](#)
- [Gastronomët shqiptarë në Gjermani](#)
- [Mantelbardhët shqiptarë në Zvicër](#)
- [Mantelbardhët shqiptarë në Gjermani](#)
- [Mantelbardhët shqiptarë në Austri](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Turizëm](#)
- [Kultura](#)
- [Intervista](#)
- [Koronavirusi: çast pas çasti](#)
- [Lifestyle](#)
- [Autotech](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Fun](#)
- [Bota](#)
- [Tema nga terreni](#)
- [Made in Kosova](#)
- [Fotolajmi](#)
- [Takimi](#)
- [Dosjet](#)

Na ndiqni:

-
-

Kosova

Kryetari i PDK-së: Nga sot fillon një fazë tjetër

E shtunë, 5 Shtator 2026 - 16:30 albinfo.ch




Foto FB: Bedri Hamza

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka deklaruar se ky subjekt nuk do të pranojë vazhdimin e shkeljeve kushtetuese dhe se, nga sot, do të hyjë në një fazë tjetër të veprimit politik, institucional dhe juridik për rikthimin e ligjshmërisë dhe rendit kushtetues në vend.

Në sallën e Kuvendit, ai deklaroi se për javë të tëra deputetët e PDK-së kanë kërkuar vazhdimin e seancës konstituive, respektimin e Kushtetutës, vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullores së Kuvendit.

“Nga sot fillon një fazë tjetër. Një fazë në të cilën Partia Demokratike e Kosovës nuk do të mjaftohet vetëm duke kërkuar që ligjshmëria të respektohet. Do të veprojmë. Me përgjegjësi. Me vendosmëri. Me të gjitha mjetet demokratike dhe institucionale që na i jep rendi kushtetues i Republikës së Kosovës. Ne kemi kërkuar që ligjshmëria të respektohet. Nga sot, do të veprojmë që ligjshmëria të rikthehet”, tha ai, transmeton albinfo.ch.

Hamza u shpreh se situata e krijuar nuk është më një përplasje e zakonshme politike.

“Kjo që ka ndodhur nuk është një mosmarrëveshje e thjeshtë politike. Nuk është konflikt mes PDK-së dhe Vetëvendosjes. Nuk është konflikt mes Bedri Hamzës dhe Albin Kurtit. Është konflikt mes një mënyre autoritare të ushtrimit të pushtetit dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Pushteti nuk mund t’i trajtojë “Kushtetutën, vendimet e gjykatave dhe obligimet institucionale sipas interesit politik”, tha ai.

“Në demokraci, edhe kur nuk të pëlqen Kushtetuta, nuk e shkel atë. Kur nuk të pëlqen një vendim i Gjykatës Kushtetuese, nuk sillësh sikur ai nuk ekziston. Dhe kur Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës konstaton se deputeti nuk mund ta ushtrojë njëkohësisht edhe funksionin e ministrit, nuk mund të sillësh sikur gjykata nuk ka folur”, shtoi tutje ai.

I pari i subjektit të dytë më të madh në Kosovë kritikoi edhe thirrjen e vazhdimit të seancës konstituive për 9 shtator, duke thënë se tashmë po shkelet edhe afati sipas interpretimit të vetë Vetëvendosjes.

“Tash, vazhdimi i seancës konstituive është thirrur për 9 shtator, pas afatit prej 30 ditëve që e ka përcaktuar vetë Vetëvendosje. Por Kuvendi i Kosovës nuk mund të presë derisa një parti t’i përfundojë kalkulimet e veta. Kuvendi është institucion i Republikës së Kosovës”, deklaroi Hamza teksa theksoi se institucionet e Republikës nuk mund të mbahen peng të interesit të një partie apo individi.

Hamza tha se PDK-ja nuk do të pranojë normalizimin e shkeljeve kushtetuese, pasi sipas tij, kjo çështje shkon përtej raportit mes opozitës dhe pushtetit teksa paralajmëroi se durimi institucional i partisë nuk duhet të interpretohet si pranim i paligjshmërisë.

Ai tha se PDK-ja do të shqyrtojë forma të tjera të veprimit.


“PDK-ja do të shqyrtojë forma të tjera të veprimit politik, institucional dhe juridik për ta nxjerrë vendin nga kjo situatë dhe për ta kthyer Kosovën në binarët e ligjshmërisë”, tha ai ndërsa shtoi se beteja aktuale nuk është për pushtet, por për kufijtë e tij dhe respektimin e rendit kushtetues.

“Kjo nuk është betejë për pushtet. Është betejë për kufijtë e pushtetit. Sepse sot në pyetje nuk është se kush qeveris. Në pyetje është se si qeveriset. A qeveriset sipas Kushtetutës, apo sipas vullnetit të një njeriu?” – tha Hamza.



-
-
-
-

Të tjera nga Kosova



[27 vjetori i Policisë së Kosovë, Kurti: Shtrirje në gjithë vendin](#)

- [Kosova dhe Gjermania. hashkë kundër rriorave që bartin virusin vdekjenurës](#)

- [Kosovë: Për 8 muaj vaksinohen mbi 8 mijë fëmijë kundër fruthit](#)
- [Tre pilotë nga Kosova në Top 10 të botës në paragllajdizëm](#)

E-Diaspora



- [Shkolla shqipe hap dyert në Rickenbach të kantonit të Luzernit Një mundësi e re për fëmijët shqiptarë për të mësuar, ruajtur dhe dashur gjuhën dhe kulturën...](#)



- [Modesta Uka shënon tregolësh, dërgon Austria Wien në Ligën e Kampionëve](#)
- [Austri](#)



[19-vjeçari shqiptar gjendet i vrarë në qelinë e burgut në Austri](#)



- [Zvicër–Kosovë, tregtia arrin 175 milionë franga: Marrëveshja e re heq barrierat doganore](#)



- ["Rruga e Feve" bashkon rreth 100 persona në Wil](#)

Jeta në Zvicër



- [Kompanitë që do të shkurtojnë vendet e punës në Zvicër këtë vjeshtë Edhe pse shkalla e papunësisë në Zvicër, rreth 3 për qind aktualisht, mbetet më e ulët...](#)



- [Fondacioni i viktimave të Crans-Montanës kërkon më shumë fonde](#)



- [Pushkët gjysmëautomatike në qarkullim në Zvicër pavarësisht ndalimit](#)




- [Nga muaji tetor fillon linja e re zvicerane mbështetëse për viktimat e abuzimit online](#)



- [Shkolla shqipe hap dyert në Rickenbach të kantonit të Luzernit](#)

 Reklamë



Albinfo.TV_

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.